

Sfida e konsolidimit

Fuqizimi i pavarësisë së institucioneve të medias në Kosovë



Democracy for Development
Democraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Sfida e konsolidimit

Fuqizimi i pavarësisë së institucioneve të medias në Kosovë

Prishtinë, shtator 2013

Copyright © 2013. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citime të pasazheve të shkurtra për qëllime të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem arkivimi, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Hulumtimi i përgatitur nga: Naser Miftari



Mohim përgjegjësie: Ky raport është përgatitur në kuadër të Programit për Promovimin e Hulumtimeve Rajonale në Ballkanin Perëndimor (RRPP), nën udhëheqjen e Universitetit të Friburgut të mandatuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC, Departamenti Federal për Punë të Jashtme. Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorit dhe nuk paraqesin medoemos opinionet e SDC-së dhe Universitetit të Friburgut.

Shënim: Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit “Zhvillimi i Institucioneve Funksionale të Mediave në Ballkanin Perëndimor”, që zbatohet nga Qendra për Hulumtime Rajonale Analitika nga Bosnja dhe Hercegovina, Qendra për Hulumtime dhe Politikëbërje nga Maqedonia, Instituti Shqiptar i Medias nga Shqipëria, dhe Demokraci për Zhvillim nga Kosova. Ky projekt financohet nga Programi për Promovimin e Hulumtimeve Rajonale (RRPP) në Ballkanin Perëndimor, që ka për qëllim nxitjen dhe promovimin e hulumtimit të shkencave sociale në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe Serbi). RRPP bashkërendohet dhe drejtohet nga *Interfaculty Institute for Central dhe Eastern Europe (IICEE)* në Universitetin e Friburgut (Zvicër). Programi financohet tërësisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Departamenti Federal për Punë të Jashtme.

Përmbajtja

- Hyrje, 4
- Informata të përgjithshme, 5
- Raste studimi dhe gjetjet e tyre, 7
- Konkluzat dhe rekomandime, 18

Hyrje

Përgjatë rreth një dekade të menaxhimit ndërkombëtar sektori i medias në Kosovë ka përjetuar një transformim të rëndësishëm. Megjithatë, ende ekziston një perceptim i përgjithshëm që sistemi i medias në Kosovë ka performancë të dobët dhe se ky sektor luhatet nga të qenit stabil deri në gjendje të brishtë. Regjimi i mediave liberale i aplikuar nga administrata e OKB-së pas zbarkimit të saj më 1999 në Kosovë ishte i suksesshëm në atë që siguroi demonopolizim të informatave në Kosovë, por rritja e pakontrolluar e medimeve në vitet në vijim ka çrregulluar sektorin e medias, duke krijuar një treg të fryrë të medias, burimi i të ardhurave i të cilave pësonte rënie.

Asistenca ndërkombëtare për mediat në Kosovë është ofruar në tri faza. 1) Mbështetja për mediat opozitare gjatë sundimit serb (1990-ta) 2) intervenimi në media pas konfliktit (1999-2007), dhe 3) mbështetja e kufizuar për media (që nga viti 2007, në vazhdim e sipër). Asistenca për mediat gjatë këtyre tri fazave përbëhet nga katër lloje: 1) zhvillimi i kapitalit njerëzor; 2) mbështetje e drejtpërdrejtë për media; 3) korniza rregullative dhe 4) mbështetja për institucionet e medias. Përderisa asistenca për mediat gjatë të tri fazave ishte e konsiderueshme në të katër llojet e asistencës, donatorët nuk kanë shkuar përtej synimeve parësore - që ishin themelimi i një game institucionesh së medias dhe atyre mbështetëse. Për më tepër, si duket strategjitë, qasjet dhe synimet e asistencës së huaj nuk ishin gjithmonë të qarta dhe/apo të bashkërenduara dhe kjo pati implikime për tërë sektorin.

Informata të përgjithshme

Dy prej organizatave më të rëndësishme që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e kapitalit njerëzor në mediat e Kosovës dhe që kanë qenë gjithashtu mjaft të përfshira në themelimin e organizatave dhe instituteve të medias gjatë dekadës së fundit në Kosovë ishin OSBE-ja dhe IREX/USAID. Projektet specifike të realizuara nga OSBE-ja në një anë dhe IREX/USAID në anën tjetër ishin të gjitha të orientuara në produkte. OSBE-ja ka ndihmuar në themelimin e Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) dhe në vitet në vijim, mes tjerash, ndihmoi në themelimin e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK), Institutin e Medias të Kosovës (IMK), Komisionin e Pavarur për Media (KPM) dhe Shoqatën e Mediave të Kosovës (KOSMA). IREX Kosovë, në anën tjetër, ka qenë i angazhuar në themelimin e dy transmetuesve kryesorë komercialë me mbulim kombëtar (KTV dhe RTV 21) dhe ka punuar shumë për të siguruar ndërtimin dhe rritjen e potencialit të vetëqendrueshmërisë së këtyre mediave. Gjithashtu, ai ka luajtur rol vendimtar në themelimin e Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës (AGPK), Asociacionit të Transmetuesve (AMPEK) dhe Rrjetit Kosovar për Telekomunikacion Tokësor (RKTT). Ndërkohë, organizata dhe projekte më të vogla si Medienhilfe dhe Press Now, ndonëse në shkallë më të vogël, kanë ofruar mbështetje sistematike për gazetatat kryesore – Koha Ditore dhe Zëri dhe më herët për paraardhësit e tyre, të përjavshmet KOHA dhe ZËRI, si dhe disa projekte të tjera alternative të cilat janë shfaqur pas konfliktit. Donatorët tjerë, si Qeveria e Japonisë dhe BE-ja, përmes projekteve të ndryshme të synuara, kanë qenë të rëndësishme në ofrimin e financimit dhe teknologjisë për RTK-në dhe institucionet tjera të rëndësishme të medias dhe ky financim përbën shumicën e asistencës së donatorëve.

Kjo analizë bazohet në gjetjet e një raporti hulumtues që në mënyrë specifike ka shqyrtuar mënyrat në të cilat kanë evoluar tri institucionet e mediave – Komisioni i Pavarur për Media (KPM); Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK), të themeluara pas konfliktit me asistencë të konsiderueshme të jashtme për media. Pavarësia dhe qëndrueshmëria afatgjate e RTK-së dhe KPM-së janë kushte të rëndësishme që qeveria e Kosovës duhet t'i përmbushë¹ në rrugëtimin e saj drejt Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) me BE-në.² KMSHK gjithashtu vazhdon të jetë institucion i rëndësishëm për çështjet e mediave të shkruara në Kosovë. Prandaj, këto institucione janë bazë për një sistem të shëndoshë të medias në Kosovë.

¹ Qeveria e Kosovës, Plani i Veprimit për negociatave për MSA, dhjetor 2012

² Rekomandime për autorizimin e hapjes së negociatave për MSA ndërmjet BE-së dhe Kosovës, Bruksel, 22 prill 2013)

Raste studimi dhe gjetjet e tyre

KPM – I themeluar më 2005, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) është pasardhës i Komisionit të Përkohshëm për Media (TMC) institucion ky i themeluar më 2000, bazuar në modelin e Bosnjës³ me mandat të rregullimit dhe licencimit të mediave të shtypura dhe transmetuese në Kosovë. KPM ka trashëguar një numër karakteristikash nga TMC. Të gjithë pjesëtarët e stafit (duke përfshirë Kryeshefin Ekzekutiv aktual) kanë punuar në TMC para se të punësoheshin në KPM. Para TMC-së nuk kishte rregullator të themeluar në Kosovë për monitorimin e mediave.⁴ gjatë tërë mandatit të saj, TMC është kryesuar nga ekspert të huaj, të udhëhequr nga filozofi të shumëllojshme lidhur me atë se si duhet të rregullohet (nëse duhet të rregullohet fare) sektori i medias në një shoqëri të pas-konfliktit.⁵ Pikëpamjet e ndryshme botërore që kanë orientuar punën e saj vazhduan ndikimin e tyre në mënyrën e veprimit të KPM-së.

Donatorët kryesorë ndërkombëtarë për KPM-në ishin OSBE-ja, IREX/USAID dhe Komisioni Evropian. Qasjet e donatorëve ndaj KPM-së përshinin reforma ligjore, ndërtimi i institucioneve, mbështetja teknike (pajisje/softuer dhe sisteme të monitorimit), paga, ngritja e kapaciteteve dhe trajnimet (brenda apo jashtë vendit), si dhe fushatat e ndërgjegjësimit. Përderisa periudha e përkohshme para kosovarizimit është mbështetur pjesërisht nga OSBE-ja (d.m.th. paga për anëtarët ndërkombëtarë të bordit në periudhën 2006-2008), kjo agjenci ka pranuar vetëm një

³ Stacy Sullivan, "Ristrukturimi i medias në shoqëritë pas konfliktit: Katër perspektiva – Përvoja e organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare." Studim për Konferencën e UNESCO-s për Ditën Botërore të Mediave të Shkruara, Gjenevë, maj 2000.

⁴ Shih: Sullivan 2000.

⁵ Empire Lite as a Swamp, Anna Di Lellio, http://dev.ulb.ac.be/cevipol/dossiers_fichiers/7-di-lellio.pdf

grant fillestar prej 20.000 euro nga OSBE-ja më 2006 si pjesë e një fushate ndërgjegjësimiti. Që atëherë, financimi për KPM-në kryesisht erdhi nga buxheti i Kosovës. Megjithatë, donatorët ndërkombëtarë vazhduan të luajnë rol qendror në asistencën për KPM-në. Më 2009 KPM pranoi një grant nga Komisioni Evropian (KE) në shumë prej një milionë euro për avancimin e sistemit të saj të monitorimit. Përveç sistemit të monitorimit të siguruar përmes grantit të KE-së, projektet tjera që KPM-ja ka pranuar që nga viti 2006 ishin projekte/aktivitete të vetme afatshkurtre. Ndonëse asistenca për KPM-në ishte e bashkërenduar – synimet për KPM-në, bazuar në informatat kthyesë nga të intervistuarit, nuk ishin realizuar.

Vitin e parë të veprimtarisë së saj, KPM ka miratuar rregulloren e brendshme të punës, kodin e etikës, politikën për nxjerrjen e rregullave publike, politikën e transmetimit dhe udhëzimet për ndëshkime.⁶ Megjithatë, pas kosovarizimit, KPM-ja u përball me një numër sfidash dhe vështirësish siç janë mungesa e stafit me kualifikime profesionale, mungesë fondesh, mungesë pajisjesh, e kështu me radhë. Ndonëse KPM çdo vit merr financim nga Ministria e Financave, mungesa e njohurisë se si të pozicionohet më mirë në dinamikën e ndryshueshme të sektorit të transmetimit, ka lënë të pashfrytëzuar potencialin e këtij institucioni. Ai vazhdon të jetë institucion reaktiv dhe jo proaktiv.

Çështja e asaj nëse KPM mund ta mbajë pavarësinë e saj mbetet e paqartë. Ka mendime të ndara lidhur me atë nëse mbështetja për KPM-në përgjatë viteve ka prodhuar rezultate të qëndrueshme, apo me fjalë tjera nëse janë krijuar bazat që KPM të bëhet institucion i pavarur. Ka pajtime se pavarësia formale e KPM-së ekziston por është pavarësia funksionale e saj ajo që është e vështirë për t'u

⁶ Faqja e internetit e KPM-së

ushtruar për shkak të ndërhyrjeve të interesave politike dhe biznesore. Në veçanti, imponimi i vendimeve ndaj RTK-së mbetet problematik. Gjithashtu, në kuptim të resurseve financiare, pavarësia e KPM-së komprometohet edhe më tej për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm të KPM-së për të negociuar me Ministrinë e Financave për buxhetin e saj vit pas viti. Për më tepër, digjitalizimi i ardhshëm, që është lidhur me fenomenin e politizimit gjithnjë më të madh të emërimeve në Bordin e KPM-së, pritet ta bëjë atë institucion edhe më të brishtë se që ishte gjatë dy viteve të fundit. Për shembull, sfidat e KPM-së (siç janë licencimi i transmetuesve apo sigurimi i pajtueshmërisë me Ligjit për të drejtat e autorit) janë trajtuar me sukses dhe pavarësia e KPM-së është mbajtur. Megjithatë, kur KPM është dashur të marrë vendim për zgjatjen e licencave për transmetim të apo sigurimin e pajtueshmërisë së RTK-së me kuotën e reklamave (të dyja këto çështje që kanë pasur implikime të mëdha politike), ajo nuk mundi ta përmbush mandatin e saj, dhe reputacioni i saj u vë në pikëpyetje. Rritja e potencialit të saj për t'u bërë financiarisht e vetëqëndrueshme është mënyra e vetme për të ardhmen e KPM-së.

RTK – Për sa i përket RTK-së, duket se përpjekjet për themelimin e një transmetuesi publik sipas modelit të BBC-së në Kosovë kanë dështuar dhe kanë prodhuar një transmetues që vazhdon të jetë nën ndikim të fuqishëm të qeverisë. RTK madje mund ta ketë edhe më të vështirë që të arrijë autonomi për aq kohë sa nuk i rivlerëson synimet dhe orientimet e saj të cilat e bëjnë atë të cenueshme ndaj ndikimeve politike. Një synim i tillë do të duhej të ishte që të hiqet dorë fokusi i saj në agjendën gjeopolitike dhe të ketë më shumë fokus në agjendën sociokulturore.

Kur RTK filloi me transmetim më 1999, roli i saj qendror ishte përmbushja e synimeve specifike sociale dhe politike (promovimi i paqes, shumetnisë dhe shumëllojshmërisë). Jo

vetëm që RTK-ja e përbushi këtë synim, por ajo edhe u bë kampione e tij në mënyra të rëndësishme. Megjithatë, me kalimin e kohës, RTK mëtoi t'i përbushë disa objektiva të rëndësishme specifike për media – siç është synimi për të pasur buletin më të mirë të lajmeve dhe programin më të mirë të aktualiteteve, duke e futur vetëm në konkurrencë me transmetuesit komercialë në mbulimin e çështjeve të politikës, në një kohë kur ata transmetues ende mbështeteshin nga donatorët. Ajo që në fakt ndodhi ishte se u ngatërrua në një konkurrencë të padrejtë me transmetuesit komercialë, duke u bërë me tërheqës për politikanët që ta shfrytëzojnë këtë në favor të agjendave të tyre politike. Duke pasur parasysh potencialin e veçantë të RTK-së për një gjë të tillë (për shkak të kapaciteteve të saja teknike dhe depërtimit më të madh tek audiencia ku buletinet e lajmeve arrinin audiencia prej rreth 500,000) përparësia e saj u shndërruan në dobësi. Kosova, si shoqëri e pas konfliktit, duhet të ketë shërbyes publik të llojit të RTK-së që të vazhdojë t'i ofrojë të gjitha llojet e informatave dhe gjithashtu duhet të ketë pavarësinë e saj. Megjithatë, për sa kohë RTK-ja të ketë politikën në fokus të agjendës së saj politikanët me gjasë do të vazhdojnë të bëjnë përpjekje që ta shfrytëzojnë dhe abuzojnë atë. Në vend të politikës ditore, fokusi i RTK-së duhet të jetë në ngjarjet politike. Me fjalë tjera, të ndërpritet mbulimi i politikës së partive dhe të ketë më shumë fokus në avancimin e agjendës kulturore të Kosovës si shtet i ri, nëse dëshiron ta mbajë pavarësinë në të ardhmen.

Logjika prapa kërkesës për një zgjidhje të tillë për RTK-në, qëndron në faktin se Kosova viteve të fundit ka një spektër më të shumëllojshëm të mediumeve dhe transmetuesve rajonalë, në të cilat akterët politikë mund të garojnë me sukses dhe kjo mund të shërbejë si pikë daljeje për RTK-në, që gradualisht të largohet nga mbulimi politik, në veçanti nga fokusi i saj në agjendat ditore të partive politike dhe të riorientohet më shumë drejt një agjende më të gjerë

sociokulturore, njëkohësisht duke i kushtuar vëmendje aspektit shumetnik dhe diversitetit në shtetin e ri të Kosovës. Fundja, Ligji për RTK-në i vitit 2012 parasheh një rol të tillë në mjaft hollësi dhe mund të shërbejë si udhërrëfyes për një transformim të suksesshëm.

Është e qartë se viteve të fundit RTK-ja gjithnjë e më shumë është bërë shënjestër e interesave politike, ekonomike dhe të tjera të palëve të shumta të interesit të cilat e shohin RTK-në si aset të rëndësishëm strategjik dhe ajo do të vazhdojë të jetë e cenueshme ndaj ndërhyrjeve nëse nuk e ndryshon rolin e saj si transmetues publik. Modeli që ka ndjekur në të kaluarën mund të shërbejë si udhërrëfyes. Në periudhën 2002-07 RTK-ja bëri shumë përpjekje për të arritur pavarësi financiare nga buxheti i Kosovës, duke pasur parasysh varshmërinë e saj në opinion publik të Kosovës (përmes tarifës së parapagimit) si rezultati më i mirë i mundshëm.⁷ Parapagimi i inkasuar përmes KEK-ut i siguroi RTK-së një qëndrueshmëri solide financiare në periudhën 2003-2009. Por, ky aranzhim nuk lejonte shumë hapësirë për ndërhyrje politike në RTK-në, prandaj në një moment, një vit para skadimit të kontratës ndërmjet KEK-ut dhe RTK-së, KEK-u (i cili pretendonte se i shkaktoheshin humbje nga ky aranzhim) vendosi që njëanshëm ta ndërpresë kontratën.⁸ Pastaj, Gjykata Kushtetuese e Kosovës pezulloi parapagimin, duke e konsideruar atë si jokushtetuese.⁹ Menaxhmenti i atëkohshëm i RTK-së e konsideroi këtë zhvillim si përpjekje të politikës për të ndërhyrë në RTK-në në prag të zgjedhjeve

⁷ Raport Vjetor për vitin 2005 – Radio Televizioni i Kosovës f. 5, 2006

⁸ Qëndrueshmëria financiare e RTK-së: Gjetja e një alternative për financimin e transmetuesit publik, Analizë e GAP, 12 tetor 2011. Gjykata ka kërkuar nga Kuvendi që ta shqyrtojë nenin 20.1 të Ligjit për RTK-në (2006) deri më 1 dhjetor 2009. Më 14 qershor 2010 ajo e zgjati masën e përkohshme deri më 1 janar 2011. Rasti është ende i hapur.

⁹ GAP Analizë, tetor

të vitit 2007.¹⁰ RTK gjithashtu citoi mungesën e mbështetjes së UNMIK-ut në vazhdimin e inkasimit të parapagimit, përkundër rekomandimeve të EBU-së për të kundërtën.¹¹ Pas ndërprerjes së kontratës nga ana e KEK-ut, e cila i jepte RTK-së gjashtë muaj për të gjetur një alternativë, Kuvendi i Kosovës e zvarriti këtë çështje edhe më tej me dështimin e tij për të miratuar ligjin e ri për RTK-në. Gjithashtu, edhe mungesa e gatishmërisë së menaxhmentit dhe bordit të RTK-së për të propozuar zgjidhje alternative shkaktoi pasoja të mëtejme. Në mungesë të një zgjidhjeje, më 2010, nga një situatë në të cilën siguronte më shumë se 80% të të ardhurave të saj nga parapagimi (2007) dhe të tjerat nga reklamat, RTK-ja kaloi në varshmëri të plotë nga buxheti i Kosovës.

Aktualisht, një çështje mjaft shqetësuese është mungesa e gatishmërisë së menaxhmentit të ri të RTK-së për të propozuar futjen e sërishme të parapagimit. Duket se menaxhmenti i RTK-së ndjen rehati me status kuonë dhe nuk është në gjendje apo e gatshme që të kërkojë futjen e sërishme të tarifës së parapagimit.

Aktualisht, RTK nxjerr rreth 1/7 e buxhetit të saj nga të ardhurat nga reklamat dhe resurset tjera. Megjithatë, vazhdimësia e saj si transmetues publik mund të vihet në pikëpyetje nëse në periudhën nga tani dhe 2014 nuk arrin të gjejë një zgjidhje afatgjate të financimit – qoftë përmes tarifës së transmetuesit qoftë një mekanizmi tjetër të aprovuar reciprokisht. Si opsion i fundit, ajo mund të vazhdojë me varshmërinë e saj në buxhetin e Kuvendit të Kosovës por ajo do të duhet t'i caktojë kushtet e saj për sa i përket rolit që do ta luajë. Aktualisht, ajo ende kryesisht

¹⁰ Raport Vjetor i RTK-së për vitin 2007: Raporti citon komentin e një zëdhënësi qeveritar se ‘futja e sërishme e kontratës me RTK-në mund të bëhet nëse ajo ndryshon politikën editoriale ndaj qeverisë’ si shenjë se politika ishte prapa ndërprerjes së kontratës.

¹¹ Raport Vjetor për vitin 2007 – Radio Televizioni i Kosovës f. 7

shihet si zëdhënese e qeverisë dhe rrjedhimisht (për shkak të mënyrave në të cilat përqendrohet në mbulimin e agjendave të politikës ditore) si zëdhënese e partive politike. Kësaj qasje duhet t'i jepet fund.

Implikimet për sa i përket ruajtjes së pavarësisë së RTK-së kanë qenë të qarta. Në veçanti, që nga viti 2008, gjersa rritej varshmëria e RTK-së në buxhetin shtetëror, Qeveria e Kosovës është akuzuar për ndërhyrje në pavarësinë e RTK-së.¹² Përveç kësaj, RTK-ja është kritikuar gjithnjë e më shumë për forcimin e lidhjeve të nepotizmit në radhët e saj, për faktin që ishte tejet zemërgjerë në blerjen e programeve nga produksione të jashtme dhe për disa nga produksione selektive të saj të brendshme – shpeshherë me cilësi të diskutueshme – duke paguar shuma të majme parash për udhëheqësit e këtyre programeve për t'i mbajtur në transmetim. Një numër artikujsh dhe dokumentesh hulumtuese janë shpërfaqur kohëve të fundit të cilat flasin për këto probleme. Kohëve të fundit RTK-ja ka ndërmarrë disa hapa për uljen e potencialit për keqmenaxhim. Ajo ka shpallur tender të hapur në faqen e saj të internetit për blerjen e produksioneve të jashtme. Gjithashtu, ajo vazhdon të publikojë raportet vjetore dhe dokumente të tjera të rëndësishme të cilat janë të qasshme në faqen e saj të internetit, shenjë kjo e një përpjekjeje kontekstuale për të pasur më shumë transparencë. Por, duhet të bëhet shumë më shumë për të siguruar transparencë të plotë në këtë institucion në të ardhmen.

Në nivelin funksional, çështja e trashëgimisë së të drejtave dhe obligimeve mbi ish transmetuesin shtetëror (RTP) është një sfidë tjetër e rëndësishme e cilat ka ndikim në rritjen e RTK-së (meqë nuk konsiderohet pasardhëse as faktike as ligjore e RTP-së, ajo nuk mund të fitojë shfrytëzim të përhershëm të objektit në të cilin ndodhet. Me fjalë tjera,

¹² Monitorimi i Programit Informativ të Radio Televizionit të Kosovës, 2011/01, KIPRED, Prishtinë, janar 2011

RTK-ja e konsideron veten si banore në objektin që do të duhej të ishte shtëpia e saj. Ky fakt ka implikime për sa i përket politikave të punësimit dhe kapacitetet operationale të saj kanë mbetur peng i një vendimi të përhershëm i cili do të duhet të merret në Kuvendin e Kosovës. Kjo ka implikime të drejtpërdrejta në trajtimin e çështjes së rreth 1200 ish punonjësve të RTP-së, të përjashtuar nga puna në vitet e 1990-ta, të cilët avokojnë për të drejtat e tyre për t'u kthyer në vendet e punës dhe për t'i marrë përfitimet si ish punonjës. Më 2006, qeveria e Kosovës ka përgatitur një projektligj për bartjen e pronësisë së RTP-së tek RTK-ja, por strategjia u braktis pas një refuzimi nga Sindikata e ish punonjësve të RTP-së dhe kjo çështje vazhdon të jetë e hapur. Në këto rrethana, RTK-ja është detyruar që të aplikojë një lloj diskriminimi pozitiv në politikën e saj të punësimit dhe rezultat i kësaj ishte një rritje e numrit të stafit me cilësi të diskutueshme.

Në fund, ekziston edhe shqetësim legjitim i politizimit të transmetuesit. Pas zhvendosjes së financimit nga parapagimi tek Kuvendi i Kosovës, procesi është karakterizuar me një numër sfidash në menaxhim. Së pari, drejtori i përgjithshëm i institucionit dha dorëheqje më 2011, për shkak të presionit politik¹³ dhe Bordi emëroi pasardhësin e tij – ish kryeredaktorin e RTK-së – drejtor të përkohshëm.¹⁴ Më 2013, anëtarët në largim të Bordit të RTK-së emëruan Drejtorin e Përgjithshëm të ri, gjersa emërimi i Bordit të ri të RTK-së ende nuk ishte kryer në Kuvendin e Kosovës. Disa të intervistuar, duke reflektuar për faktin që Bordi në largim kishte emëruar Drejtorin e Përgjithshëm të ri, e kuptuan këtë si një tjetër shenjë të politizimit të transmetuesit dhe joformalitetit të mëtejshëm në funksionimin e RTK-së.

¹³ Monitorimi i Programit Informativ të Radio Televizionit të Kosovës, 2011/01, KIPRED, janar 2011

¹⁴ Po aty

KMSHK – Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (*KMSHK*) është themeluar në qershor të vitit 2005 si mekanizëm vetë-rregullues për mediat e shkruara të Kosovës.¹⁵ Themelimi i *KMSHK*-së ishte një nga ‘standartet’ që Kosova duhej t’i përmbushte për vazhdimin e bisedimeve për status dhe parakusht në mënyrë që TMC të tërhiqte kontrollin mbi mediat e shkruara. Para themelimit të *KMSHK*-së, nuk kishte mekanizëm vetë-rregullues për mediat e shkruara në Kosovë.

Që nga themelimi, *KMSHK* ka realizuar veprimtarinë e tij kryesisht bazuar në donacione të huaja dhe tarifat e anëtarësisë për mbulimin e kostove operationale. Ndonëse shpenzimet e tij operationale janë të ulëta (ndërmjet €40,000-50,000 në vit) duket se *KMSHK* është larg gjetjes së një zgjidhjeje që do ta bënte atë të vetëqëndrueshëm dhe ekonomikisht të pavarur në kuptim të plotë të fjalës në të ardhmen. Tarifat e anëtarësisë nuk janë të rregullta dhe në rastin më ideal ku do të paguanin të gjithë anëtarët, shumat e inkasuara nuk mjaftojnë për ta mbuluar veprimtarinë vjetore të tij. Sipas disa vlerësimeve të mëhershme, 95% të buxhetit të *KMSHK*-së varet nga ndihma e huaj dhe vetëm 5% në pagesat e anëtarësisë. Në raportin e tij vjetor për vitin 2012, është theksuar se vetëm tre medime kanë paguar obligimet e tyre vjetore.

Gjersa asistenca e donatorëve në rastin e *KMSHK*-së ishte e bashkërenduar, paaftësia e *KMSHK*-së për ta kaluar pragun e qëndrueshmërisë tetë vite pas themelimit vazhdon të jetë problem i rëndë. Deri në një shkallë, nga tri institucionet e themeluar në Kosovë pas konfliktit, *KMSHK* ngjason më së shumti me të ashtuquajturin “efekti i transplantit”¹⁶ meqë fuqia e tij qëndron në besimin se parimet etike të medias

¹⁵ Filip Stiglmyer, Këshilli i Mediave të Shkruara me mbështetje të OSBE-së ndihmon në krijimin e një mjedisi më të mirë të mediave të Kosovës, mars 2007

¹⁶ Daniel Berkowitz, Katharina Pistor dhe Jean-Francois Richard (2003), ‘Efekti i transplantit, Gazeta Amerikane e së Drejtës Krahasuese, Vol. 51, f. 163-187.

dhe gazetarëve do të mbizotërojnë dhe në shtetet me ndryshime të vazhdueshme siç është Kosova një besim i tillë mund të jetë tejte ambicioz. Për më tepër, gjendja e mjerueshme në të cilën veprojnë mediat e shkruara në Kosovë ulin gjasat që një mekanizëm e përshtatshëm financimi do të mund të gjendet së shpejti, përveç nëse qeveria nuk ndan mjete, mbase sipas disa modeleve skandinave të cilat aplikohen në masë të madhe, dhe drejtpërsëdrejti apo tërthorazi të bëjnë të mundur mbështetjen financiare për këtë institucion, rëndësia e të cilit ende nuk mund të shpërfillet.

Nga aspekti praktik, që nga themelimi i tij, KMSHK ka arritur t'i publikojë të gjitha vendimet e tij në faqen e internetit dhe ka qenë konsistent. Megjithatë, nuk është e qartë se sa shpesh janë marrë parasysh apo shpërfillur kërkesat e KMSHK-së drejtuar mediave anëtare dhe joanëtare për të lëshuar kërkimfalje publike apo përmirësime. Që nga themelimi i tij, KMSHK ka zgjidhur 162 ankesa, (rreth 20 në vit, mesatarisht).

Sikurse dy institucionet tjera, KMSHK ka pasur sfida të ngjashme institucionale për sa i përket ushtrimit të rolit të tij në mënyrë të drejtë kur është përballë me çështje të cilat kanë mundur të nxitin ndërhyrje politike ndaj institucionit. Në rastet kur kjo ndodhte, pësonte reputacioni i tij. Do të kishte qenë në pozitë shumë më të mirë nëse do të zotohej se do t'i ikte tërësisht trajtimit të çështjeve që kanë implikime politike dhe t'i referonte ato në gjykata, sesa të mendohej t'i trajtonte dhe të përfundonte me dyshime ndaj reputacionit të tij.

Për më tepër, fakti që pas dështimit për herë të dytë që t'i mbledh gjobat e shqiptuara ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'i inkasuar ndëshkimet e shqiptuara e bën edhe më të vështirë gjetjen e rrugëzgjidhjeve për të siguruar qëndrueshmëri në të ardhmen. Pavarësia e KMSHK-së nuk

është prekur nga politika, por ka dyshime lidhur me atë se medime (anëtare dhe joanëtare) do të vazhdojnë t'i respektojnë vendimet jo të obligueshme të tij dhe në çfarë mase do të zbehet reputacioni i tij nëse gjykatat e Kosovës bëhen më të efektshme në të ardhmen.

Konkluzë dhe rekomandime

Gjetjet e raportit hulumtues nga i cili është bazuar kjo analizë sugjerojnë se roli i asistencës së huaj dhe financimit ndërkombëtar në zhvillimin e sistemit të medias në Kosovë ishte vendimtar. Këto gjetje janë konfirmuar nga një numër intervistash (16 intervista) me përfaqësues të institucione të medias, gazetarë, aktivistë të shoqërisë civile dhe akademikë të Kosovës në periudhën dhjetor 2012-mars 2013.

Ajo që ka arritur të ritheksojë analiza e hulumtimit është se në përgjithësi çështje e ndërhyrjes politike në institucionet e medias është intensifikuar pas ‘kosovarizimit’ dhe pas dorëzimit të tyre institucionet u shndërruan në “kontekst ballkanik.”

Ajo që duket se ishte jashtë kontrollit të donatorëve megjithatë ishin kushtet e mjedisit në të cilin janë themeluar institucionet e medias në Kosovë dhe mungesa e një njohurie më të madhe për të siguruar qëndrueshmëri të tyre pas themelimit të tyre.

Një ekzaminim më i afërt i kushteve të RTK-së, KPM-së dhe KMSHK-së tregon në një numër sfidash me të cilat këto institucione të medias janë përballur në rrugën drejt konsolidimit të tyre. Financimi vazhdon të jetë çështje kyçe për të tri institucionet. Politizimi nga shteti me nuanca të ndryshme ka shkuar në dëm të pavarësisë më të madhe në rastet e KPM-së dhe RTK-së dhe është pasqyruar në politizim të emërimeve dhe ligje të ndryshueshme që pengojnë funksionimin e mirëfilltë të të dy institucioneve. Në rastin e KMSHK, politizimi duket se ka pasur ndikim të tërthortë në punën e institucionit.

Të tri institucionet vazhdojnë të varen në donatorë apo në masë të madhe në buxhetin e Kosovës, përkundër faktit që nevojitet stimulim i vogël që ato ta kalojnë pragun e vetëqëndrueshmërisë apo ta sigurojnë potencialin për

autonomi më të madhe. Në veçanti, varësia financiare dhe kushtëzimi që shoqërohet me të, i mban peng kur flasim për parashikimin e një pavarësie formale dhe/apo funksionale në periudhën afatgjate.

Në rastin e Kosovës, mund të vërehet se të tri institucionet e medias në shqyrtim kanë kaluar në procese të rëndësishme të ndryshimit gjatë të cilit janë ndryshuar ligjet që dirigjojnë veprimtarinë e tyre, me qëllim të rritjes së kontrollit politik mbi to. Apo, sikurse në rastin KMSHK-së, janë ndryshuar statutet për të heqë dorë vullnetarisht nga disa kompetenca të caktuara. Proceset e zvarritura përmes së cilave janë futur ndryshimet në ligjet që rregullojnë veprimtarinë e KPM-së dhe RTK-së dhe fakti që pas miratimit këto ndryshime kanë cunguar një pjesë të pavarësisë së të dy institucioneve janë për t'u shqetësuar. Ndryshimet e viteve të fundit në ligjet e RTK-së dhe KPM-së, si dhe ndryshimet në statutin e veprimtarisë së KMSHK-së kanë zbehur pavarësinë e të tri institucioneve, përkatësisht rëndësinë e tri institucioneve dhe një numër të intervistuarish të konsultuar për këtë hulumtim kanë nxjerrë përfundime të ngjashme.

Kur flitet për ruajtjen e pavarësisë së tyre formale apo madje asaj faktike, institucionet si KPM dhe RTK duket se janë në pozitë më të mirë, meqë ato mund t'i subvencionojmë pjesërisht operacionet e tyre bazuar në të ardhurat që i gjenerojnë. KPM arrin të mbledhë një çerek apo më shumë të buxhetit të tij aktual nga tarifat e licencimit. Nëse i lëmë anash nevojat e kohëpaskohshme për investime kapitale, duket se KPM është më së afërmi drejt arritjes së vetëqëndrueshmërisë financiare, nëse hulumtohen ide tjera për rritjen e të ardhurave nga licencat.

RTK ende gjeneron rreth një të shtatën e buxhetit nga reklamat dhe burimet tjera të të ardhurave. Megjithatë, pavarësia e saj do të lidhet ngushtë me vendimin për futjen e parapagimit.

KMSHK vazhdon të jetë institucioni më problematik për sa i përket financimit, ndonëse ka nevojë për shumë më pak fonde për veprimtarinë e tij sesa dy institucionet tjera. sipas disa vlerësimeve të mëhershme, 95% e buxhetit të KMSHK-së (rreth € 50,000) varen nga ndihma e huaj dhe vetëm 5% nga pagesat e anëtarësisë. Në raportin e tij vjetor për 2012, është theksuar se vetëm tre medime i kanë paguar obligimet e tyre vjetore, nga mbi 18 anëtarë.

Ndryshe duket se është rikonfirmuar se bashkërendimi ndërmjet donatorëve nën nivelin e përgjithshëm (në disa raste gati i papërfillshëm) si dhe dështimi i donatorëve për t'u pajtuar për mënyrën më të mirë të përcaktimit të synimeve dhe drejtimeve strategjike të projekteve të tyre ka shkaktuar konfuzion dhe polarizim në sektorin e medias, duke rezultuar në një rënie të përgjithshme të gazetarisë cilësore dhe dobësim të potencialit të medias në Kosovë. Ndryshe, kjo i ka shërbyer politikanëve si mundësi për të bërë përpjekje për të ushtruar ndikim në media. Duket se tërheqja e shpejtë e donatorëve dhe dështimi i tyre për të lënë prapa mekanizma të duhur për të monitoruar më për së afërmi përmbajtjen e prodhuar dhe proceset e emërimeve (në rastin e RTK-së), si dhe cilësia e vendimmarrjes dhe pengesat e brendshme dhe të jashtme në mbajtjen e pavarësisë në periudhë afatgjate (rasti i KPM-së dhe KMSHK-së) kanë lënë pasojat e tyre. Përveç kësaj, fakti që qasja e programeve të asistencës së medias ishte thjeshtë kopjim i plotë i rasteve të ngjashme, kryesisht nga Bosnja, është për t'u shqetësuar, duke pasur parasysh suksesin e kufizuar të asistencës ndërkombëtare në reformimin e sektorit të medias në Bosnje dhe Hercegovinë.

Përmbledhtazi, duhet të theksohet se sfidat me të cilat janë përballë këto tri institucione në procesin e konsolidimit të tyre janë të lidhura ngushtë me synimet dhe objektivat e imponuara nga donatorët gjatë themelimit të mediave dhe

institucioneve të medias në Kosovë. Siç është theksuar në Rhodes (2007) dy kategori të ndërlidhura të synimeve dhe objektivave kanë drejtuar mbështetjen për mediat në Ballkanin Perëndimor 1) synimet politike dhe sociale, dhe 2) objektivat specifike të medias.¹⁷ Përshtypjet që dalin pasi t'i kemi hedhur një vështrim më të afërt performancës së tyre janë që në rastet kur synimet sociale dhe politike janë mbivendosur në ato specifike të mediave rezultatet kanë qenë të diskutueshme apo negative. Duket se pas kosovarizimit, të tri institucionet e medias në kohë të ndryshme janë lënë me 'patate të nxehtë në dorë', me fjalë tjera, është kërkuar t'i përmbushin objektivat që ishin larg potencialit apo kapaciteteve të tyre, gjë që ka njoosur reputacionin e tyre. Kështu, të tri institucionet janë përballë me të meta të konsiderueshme në funksionimin e tyre. Futja e mekanizmave që do të kursenin mediat dhe institucionet e sipërpërmendura nga presionet për t'u marrë me çështje të tilla në të ardhmen dhe për mënyrat e rritjes së vetëqëndrueshmërisë së tyre financiare mund të jetë zgjidhja më e përshtatshme për të siguruar autonomi dhe funksionalitet më të madh të tyre në të ardhmen.

¹⁷ Aaron Rhodes, Dhjetë vite të mbështetjes për mediat në Ballkan: Vlerësim, Task Forca për Media (Amsterdam: Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, 2007) f.

Lista e publikimeve

Zgjedhjet:

#1: Instituti D4D. Shtator 2011. Zbërthimi i trendeve zgjedhore 2000-2010.

#2: Instituti D4D. Mars 2012. Përshtypje e reformave: Si të rikthehet besimi në zgjedhje?

#3: Malazogu, Leon, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. Auditim i listës së votuesve të Kaçanikut: Mostër për Kosovën.

#4: Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shkurt 2013. Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme – Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik?

Marrëdhëniet etnike:

#1: Malazogu, Leon dhe Vladimir Todorčić. Nëntor 2011. Dialogu Beograd – Prishtinë: Nevojitet transformim i interesit vetanak. PER-K/Instituti D4D dhe NPC-Belgrade

#2 & #3: Malazogu, Leon, Viktor Popović dhe Shpend Emini. Mars 2012. Perspektiva e një të riu serb në Kosovë/Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë. PER-K/Instituti D4D.

#4: Malazogu, Leon dhe Florian Bieber. Shtator 2012. Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen. PER-K/ Instituti D4D.

#5: Malazogu, Leon dhe Alex Grigorev. Shtator 2012. Nga paqartësia kreative në proces konstruktiv – Si ti qasemi veriut të Kosovës? PER-K/Instituti D4D.

Interesi publik:

#1: Sejdiu, Dardan dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. ‘Taksa’ e fshehur: pse kosovarët paguajnë më shumë?

#2: Gashi, Drilon dhe Shoghi Emerson. Maj 2013. Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë.

Memorandume:

#1: D4D. Nëntor 2012. Memorandum reagues Nr. 1. Reagimi i tepruar policor.

#2: D4D. Dhjetor 2012. Memorandum reagues Nr. 2. Modeli i dy Gjermanive

Indikatorët:

#1: D4D. Nëntor 2010. Indikatori para dhe pas. Performanca e bazuar në tregues: Vlerësim vjetor 2010.

#2: D4D. Shteti në pasqyrë: Indikatorët e bazuar në performancë.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës



Demokraci për Zhvillim (D4D) është një institut hulumtues i themeluar në vitin 2010 me besimin se demokracia është parakusht për zhvillim. Themeluesit e D4D besojnë se demokracia është mjet dhe qëllim për zhvillim dhe janë të përkushtuar që të hulumtojnë dhe të përfshijnë një komunitet më të gjerë drejt këtij qëllimi.

Misioni i D4D-së është të ndikojë në proceset e zhvillimit të politikave publike në mënyrë që të përshpejtojë zhvillimin socio-ekonomik të vendit, përmirësimin e qeverisjes dhe për të përforcuar kulturën demokratike në Kosovë.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org.

